

PROGRAMI FULBRIGHT PËR STUDIUES (Fulbright Visiting Scholar Program) është një program post-doktoral që zgjat tre deri në gjashtë muaj, dhe u jep mundësi studiuesve të rinj apo me më shumë përvojë, lektorëve të universitetit dhe ekspertëve nga institucione akademike dhe kërkimi, të bëjnë kërkime dhe/ose të japin mësim në një universitet në Shtetet e Bashkuara.

FUSHAT E STUDIMIT: Aplikimet janë të hapura për të gjitha fushat e studimit.

KRITERET PËR APLIKIM

Aplikantët duhet:

- të jenë qytetarë të Republikës së Shqipërisë;
- të kenë gradën Doktor në fushën e tyre të studimit;
- të kenë të paktën pesë vjet përvojë mësimdhënie dhe/ose kërkimore në një universitet shqiptar ose institucion tjetër kërkimor;
- të kenë një nivel të mirë të gjuhës angleze të folur dhe të shkruar (ekuivalente të nivelit B2 – minimum 82 pikë; rezultatet e provimit të TOEFL nuk janë të detyrueshme në momentin e aplikimit);
- të kualifikohen për të marrë vizë J-1;
- të kenë rekorde të mira shëndetësore;

*** Kandidatët janë të detyruar të kthehen në Shqipëri për të paktën dy (2) vjet në përfundim të programit.

Për më shumë informacion, të interesuarit mund të klikojnë në [Fulbright Visiting Scholar Program 2024 – 2025 - U.S. Embassy in Albania \(usembassy.gov\)](https://usembassy.gov)

AFATI I APLIKIMIT: 15 korrik 2023

Për pyetje të tjera mund të kontaktojnë në: CultureandEducationTirana@State.Gov